



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

SHPLLJE PËR VENDE TË LIRA PUNE

Në zbatim të nenit 20 të ligjit 97/2013 “Për mediat audiovizive ne Republikën e Shqipërisë”, Vendimit të AMA-s Nr. 30 datë 16.04.2015, Vendimit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë Nr. 77/2018 “Për një ndryshim në vendimin nr. 19/2016 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), si dhe Ligjit Nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës në R.SH”, i ndryshuar, Autoriteti i Mediave Audiovizive shpall procedurat për rekrutim për pozicionet:

- 2 (dy) Anëtar të Këshillit të Ankesave, Kategoria III-a

DATA E DOREZIMIT TE DOKUMENTAVE: **07 Dhjetor 2018**

1.-Përshkrimi i punës

Qëllimi:

Në bashkëpunim me Kryetarin e Këshillit të Ankesave, të mbikqyr zbatimin e kodeve të transmetimit dhe rregulloreve të miratuara nga AMA. Ndjek transmetimet në media dhe respektimin e dinjitetit dhe të drejtave themelore të njeriut, mbrojtjen e të miturve, dhe të së drejtës për informim. Ndërgjegjësimi publik lidhur me veprimtarinë e OSHMA-ve, si dhe me respektimin e normave morale dhe etike në programet e ofruara.

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

A. Të shqyrtoj çdo ankesë, të vendosur nga Këshilli i Ankesave lidhur me transmetimin e lajmeve dhe programeve, të rregulloreve të transmetimit të shprehura në nenet 47, 52 dhe 53 të ligjit 97/2013.

B. Organizon seanca dëgjimore me palët, i sugjeron Kryetarit propozimet perkatëse që i duhen drejtuar AMA-s në emër të Këshillit të Ankesave për të marrë masa ndaj OSHMA-ve.

C. Nën mbyqyrjen e Kryetarit përgatit vetë por edhe me ekspertizë të pavarur anketime të publikut mbi problemet etike të programeve televizive.

Ç. Ndihmon në përgatitjen e buletinit 6 mujor që botohet nga AMA lidhur me nxjerrjen e rezultateve të arritura nga Këshilli i Ankesave.

D. Trajton ankesa dhe përpilon përgjigje, koordinon punën me sektorët e tjerë të AMA-s për problemet e publikut.

2.- Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret si vijon:

Kritere te përgjithshme:

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;

Kritere te posaçme:

- Të zotërojë diplomë të nivelit “Master Shkencor” ose ekuivalente me to, në Shkenca Komunikimi/Gazetari. Edhe diploma e nivelit “Bachelor” duhet të jetë në të njëjtat fusha.
- Të ketë të paktën 10 vjet eksperiencë pune me kohë të plotë në media.

Përbën avantazh:

- Kandidatët me përvojë pune mbi 3 vite në mësimdhënie në nivelet Bachelor ose Master në Shkencat e Komunikimit ose Gazetarisë;
- Kandidatët që kanë pjesëmarrje në grupe pune për ekspertizë ose studime mbi aspekte të zhvillimit të medias në Shqipëri (të paraqiten referencat përkatëse);

3.- Dokumentacioni:

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Autoritetit të Mediave Audiovizive dokumentat si më poshtë:

- a) Jetëshkrim;
- b) Kërkesë;
- b) Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor). Diplomat e marra jashtë vendit duhet të jenë të njohura nga Ministria e Arsimit dhe Sportit;
- c) Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- ç) Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, pjesëmarrje në grupe pune;
- d) Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- dh) Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- e) Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- f) Referencat përkatëse për të përforcuar aplikimin e tyre;

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 07 dhjetor 2018.

Adresa: Autoriteti Mediave Audiovizive, Rruga “Papa Gjon Pali II, Nr. 15, 1010”, Tiranë.

4.- Rezultatet për fazën e verifikimit paraprak:

Pas datës 07 Dhjetor 2018, AMA do të shpallë në faqen elektronike zyrtare listën e kandidatëve që plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe të posaçme të listuara në shpallje. Kandidatët që nuk kualifikohen do të njoftohen nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Jashtë të AMA-s, nëpërmjet adresës së tyre të e-mail, për shkaqet e moskualifikimit

Kandidaturat e paraseleksionuara për pozicionet e Anëtarëve të Këshillit të Ankesave i paraqiten Këshillit të AMAs. Në bazë të pikës 1, neni 20 të ligjit 97/2013, përzgjedhja e kandidatëve fitues bëhet nga AMA me shumicë të cilësuar.